



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 08/2025

I Mbajtur në takimin e VIII-të të rregullt të KPF-së me datën 27.08.2025, në sallën e takimeve në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VIII-të të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Propozim – Vendim për Miratimin e Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, si dhe Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) planeve Ndërkomunale për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Klllokotit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë;
5. Propozim – Vendim për subvencionimin e Transportit Urban dhe Urbano – Periferik dhe
6. Të ndryshme.

Pasi kryesuesi i kuvendit e lexoj rendin e ditës pyeti të pranishmit nëse ka dikush diçka rreth rendi të ditës dhe pasi nuk pati kryesuesi ia kaloi fjalën Drejtorit Alberton Sahiti për ta elaboruar propozimin për planin e integruar për menaxhimin e mbeturinave, Drejtori theksoi që është një

plan i jashtëzakonshëm për menaxhimin e mbeturinave, ky plan është punu nga shumë ekspert s' bashku me GIZ-in gjerman edhe ministria e ka dhënë pëlqimin dhe kërkoj miratimin e juaj.

Kryesuesi pyeti a parashihet ndonjë betoni për grumbullim, drejtori potencoi që po janë të parashikuar 2 deponi të mëdha.

Kryesuesi pyeti nëse dëshiron dikush të diskutoj dhe pasi s'pati kaloi me 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi ia kaloi fjalën përsëri Drejtorit Alberton lidhur me subvencionimin e transportit urban dhe urabno – periferik, i cili theksoi që i kemi korrigju disa pika dhe tarifat janë 0.60 cent për urban dhe 0.40 për urbano - periferik, i kemi kategorizu edhe kategoritë për subvencionim janë pensionistët kategoritë e dala nga lufta dhe personat me aftësi të veçanta.

Shqipe Jashari propozoi që edhe familjet me asistencë sociale të përfshihen.

Lumnije Morina theksoi që s'kam diçka të veçantë me shtu, mirëpo po i them drejtorit që tash kjo pikë është e detajuar, dhe jo si ka qenë, ndërsa si kërkesë kërkoj që të ketë tabela dhe numra që të dihet se ka po lëvizin ata autobusë, ka është plani i qarkullimit, orari, e kështu me radhë.

Kryesuesi pasi konstatoi që ska të interesuar për të diskutuar pyeti se kush është për dhe kjo pikë kaloi në kuvend me 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenim.

Te të ndryshme :


Flamur Istrëfi, Kryesues kam pyetje apo kërkesë që të jetë në seancë Raporti i Auditorit.

Kryesuesi e konstatoi të mbyllur këtë seancë të KPF-së, shihemi në Kuvend.

Procesmbajtësi


Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi